



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 03.11.2017



RAPORT PËR MUAJIN TETOR 2017

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë kemi vazhduar inspektimin e atyre shkollave që nuk kanë qenë në nivelin e duhur higjienik në inspektimet e mëhershme, bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë në Drenas për taksë komunale. Gjithashtu inspektim i subjekteve afariste që shfrytëzojnë hapsiren publike me qëllim të zbatimit të vendimit të KK-Drenas me nr. 12-400-36766 i datës 04.07.2017.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka inspektuar ato shkolla në të cilat ka hasë në parregullsi në inspektimet e kaluara, ku shihet një përmirësim i kushteve të tyre, gjithashtu ka inspektuar furrat e bukes dhe ka shqiptuar gjoba për parregullsit e hasura.

Inspektori i Ndërtimit ka inspektuar subjektet afariste që shfrytëzojnë hapsiren publike duke urdhëruar të aplikojnë për leje përkatëse. Gjatë këtij muaji është bërë rrënimi i dy objekteve të ndërtuara pa leje (anekse të lokaleve afariste) në Drenas, përmes Kompanisë së rrënitit "ASS" sh.p.k

Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka bërë mbikqyerje të punimeve (në cilësinë e Organit mbikqyrës):

- në projektin për rregullimin e varrezave në fshatin Shtuticë
- në projektin për rregullimin e rrethojave të shkollës në fshatin Baicë, Abri dhe Gllanasellë.

Gjithashtu ka qenë pjesë e Komisionit për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësit natyrore duke shqyrtuar 19 kërkesa, me qrast është bërë raport i vlerësimit për 25 objekte të ndryshme.

Inspektorët e Tregut kanë inspektuar në veqanti tregtarët lëvizës dhe largimin e tyre nga shitja në vendin jo adekuat (shitësit e druve dhe thëngjillit) si dhe të gjitha pikat e shitjes së derivateve të naftës me qëllim të kontrolles së licencave të punës si dhe çertifikatës së cilësisë së derivateve.

Inspektori Financiar ka vazhduar me inspektim të bizneseve rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime në shqyrtim të kërkesave të qytetarëve si dhe urdhëresë për ato subjekte të cilat nuk janë kyqur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Inspektori i Komunikacionit ka qenë në pushim vjetor.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punes në shifra për muajin tetor 2017:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjaba mandat.	Kërkesa	Pëlqim për biznes	Shqyrtim i Kërkesave	Rrënim i objekteve
I.Sanitare	38	1	2	1	1	1	
I.Tregut	16	1		2	1	1	
I.Financiare	38						
I.komunikacionit							
I.Ndërtimit	28	2	2				2
I.Ambientit	33		1	3		3	
Gjithsej	153	4	5	6	2	5	2

Nëntor 2017

Shef i Inspekcionit: ARIANA SADIKU